

MBI VËLLIMIN E PËRGATITUR PËR BOTIM
“HISTORIA E POPULLIT SHQIPTAR (1939-1990)”, VËLL. IV,
Shtëpia botuese “Toena”, Tiranë 2008, 455 f.

Vepra “Historia e Popullit Shqiptar (1939-1990)”, vëll. IV, është përgatitur nga një grup autorësh, të cilët janë përfshirë në një projekt të tillë shkencor prej 10 vjetësh.

Redaktimin shkencor të këtij vëllimi e ka bërë prof. dr. Xhelal Gjeçovi, historian i njohur që ka studiuar problemet historike që lidhen me zhvillimin e Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri.

Përgatitja dhe botimi i një teksti të tillë akademik është bërë me kohë i domosdoshëm për lexuesin shqiptar dhe të huaj. Domosdoshmëria e këtij botimi ka arsyet e veta që lidhen me transformimet e tranzicionit të vendit drejt demokracisë, të cilat kërkojnë një proces ridimensionimi të historiografisë shqiptare, si rezultat i zbatimit të metodave të përparuara shkencore që mënjanojnë politizimet dhe ideologjizimet e historisë.

Koha prej afro një çerek shekulli, që ka kaluar nga botimi i mëparshëm i tekstit akademik, e bën të nevojshëm këtë botim të ri, për të pasqyruar në të, të gjitha arritjet e fundit, më të reja, të historiografisë.

Një arsye më tepër për domosdoshmërinë e këtij botimi përbën kërkesa për trajtimin tërësor të historisë së shqiptarëve, jo vetëm brenda kufijve politikë të Shqipërisë, por edhe në trevat e tyre etnike dhe në diasporë.

Me dëshirën dhe motivimin e realizimit të këtyre kërkesave themelore, grupi i autorëve e ka kaluar në shtyp këtë vëllim. Siç thuhet dhe në parathënien e tij, për të kanë punuar specialistë të fushave përkatëse, të cilët punojnë në institucione shkencore e mësimore të vendit dhe nga Kosova.

Përmbajtja e këtij vëllimi është paraqitur, sipas një strukture të përcaktuar nga kritere historike dhe tematike, në përputhje me peshën dhe intensitetin e ngjarjeve historike. Afro gjysmën e vëllimit e zë pjesa e parë dhe e dytë (rreth 160 f.), e cila trajton në 6 kërçë ngjarjet që pasqyrojnë historinë e shqiptarëve në Luftën e Dytë Botërore. Në pjesën e dytë që përfshin historinë e shqiptarëve pas lufte (1945-1990), pasi parashtrihen në mënyrë të sintetizuar alternativat e zhvillimit të vendit, kur Shqipëria bënte pjesë në sistemin komunist, trajtohen të gjitha problemet e zhvillimit të vendit, si dhe trevave shqiptare e diasporës në këtë periudhë të historisë.

Problemet më të rëndësishme që gjejnë trajtim në tekst kanë të bëjnë me organizimin e regjimit komunist, me shndërrimet ekonomike e shoqërore, me qëndresën kundër regjimit komunist me zhvillimet në superstrukturën politike,

me masat sociale në ekonomi, në arsim dhe shkencë, me marrëdhëniet ndërkombëtare, me ngjarjet historike në Kosovë e në Çamëri pas lufte etj.

Në dy krerë të veçantë janë trajtuar problemet me të cilat u ndesh Shqipëria, në fushën ekonomike, politike e shoqërore, në vitet e tronditjeve të mëdha të sistemit (1960-1986) si dhe kriza e viteve 80, që çoi në rënien e sistemit komunist.

Në këtë vëllim nuk janë përfshirë ngjarjet historike, që kanë ndodhur në historinë e shqiptarëve të 28 viteve të fundit, që lidhen me vendosjen e sistemit demokratik. Kjo mospërfshirje është bërë me arsyetimin se arkivat që përmbajnë dokumentet e kësaj periudhe, sipas legjislacionit në fuqi, janë ende të mbyllura.

Siç është e natyrshme për çdo botim të ri, ky vëllim shënon një arritje të dukshme, në krahasim me botimin e mëparshëm. Shënohen si arritje të këtij vëllimi, këto aspekte:

Së pari, vëllimi përbën një trajtim shkencor më të ekuilibruar të problemeve e fenomeneve historike të Shqipërisë dhe të shqiptarëve. Analizat dhe vlerësimet e ngjarjeve historike dhe të proceseve të zhvillimit historik bëhen më me gjakftohtësi dhe me më pak emocione. Në këtë kuadër janë shmangur në një masë të konsiderueshme këndvështrimet ekstreme të politizimit si dhe tendencioziteti i theksuar i trajtimit të problemeve që ekzistonin në tekstin paraardhës.

Së dyti, në këtë botim është zbutur në mënyrë të dukshme terminologjia e ashpër, demaskuese dhe propagandistike për karakterizimin e figurave të ndryshme historike, kur veprimtaria e tyre nuk përputhej me bindjet dhe pëlqimet fikse të historianit.

Është për t'u përhëndetur se në faqet e këtij botimi janë sjellë tashmë fakte dhe dëshmi për mjaft figura që më parë kanë qenë të denigruara dhe të mënjanuara mbështetur në kritere joshkencore, me kritere politike e ideologjike.

Në këtë mënyrë vëllimi merr vlera të reja për balancimin e ngjarjeve historike, duke fituar përmasa të reja kjo pjesë e historisë sonë kombëtare.

Së treti, është bërë përpjekje e mirë për të sjellë informacion historik të vlefshëm, duke shfrytëzuar edhe burime të tjera informacioni, që nuk janë shfrytëzuar gjatë përgatitjes së botimit të mëparshëm.

Së katërti, ka refleksione të drejta e pozitive të autorëve për vlerësimin e disa ngjarjeve e proceseve historike që më parë kanë qenë tabu dhe të paprekshme.

Sigurisht, që një reflektim i tillë është rezultat i njohjes së mëtejshme të dokumentacionit dhe i burimeve të reja, të hartuara mbi metoda të përparuara shkencore. Kështu, ka një këndvështrim më objektiv për fillimet e lëvizjes së armatosur në vitin 1940, ku gjejnë pasqyrim edhe veprimtaritë e disa

nacionalistëve, të mënjeluar më parë. Ka elemente të reja konceptimi lidhur me përpjekjet për bashkim, ku afirmohet roli i A.Zogut, në përpjekjet që bëri në Turqi për të bashkuar atdhetarët shqiptarë, qëndrimi i tij, i cili nuk abdikoi dhe nuk pranoi pushtimin e Shqipërisë, si dhe peshën e zogistëve në qëndresën antifashiste në Shqipëri.

Duhet konsideruar si një hap pozitiv reflektimi që ka autori për drejtuesin e Ballit Kombëtar, Mit'hat Frashërin, të cilit nuk i atribuohen ato epitete negative të mëparshme, të pamerituara. Ai vlerësohet si një figurë me trashëgimi atdhetare, i cili vihet në krye të një organizate që “lindi si një alternativë e forcave të djathta për zgjidhjen e problemeve që preokuponin shoqërinë shqiptare nën pushtim”. Ka përpjekje të mira për të bërë një analizë të pikëpamjeve të Ballit Kombëtar, duke dalluar në të dy rrymatë të ndryshme, gjë e cila nuk është trajtuar më parë, por është konceptuar e trajtuar *en bloc* si një organizatë në shërbim të pushtuesit.

Ka evoluim pikëpamjesh lidhur me vlerësimin e vendimit të Mbledhjes së Mukjes për krijimin e KShSh. Ky i fundit trajtohet më drejtë “si një organ që do të drejtonte luftën”. Autori i afrohet së vërtetës historike, kur shprehet se tek dy forcat politike kishte një interesim të dyanshëm për marrëveshje, ndryshe nga sa është thënë më parë, se në Mukje do të shkohej për të demaskuar Ballin Kombëtar.

Autori tregohet më realist, kur trajton pasojat e prishjes së Marrëveshjes së Mukjes, duke pohuar se një “reagim” i tillë i shpejtë i Frontit Nacionalçlirimtar “nuk ishte në dobi të përpjekjeve për të arritur një bashkim sa më të gjerë forcash”.

Vihet re një qëndrim i gjykim më gjakftohtë për figurat politike që u angazhuan në qeverisjen e vendit mbas ardhjes së gjermanëve. Autori vihet në një pozitë përgjegjësie serioze për t'i dhënë përgjigje dukurisë se si një figurë si Mehdi Frashëri që gëzonte stimën e një “njeriu me parime demokratike”, “personalitet i njohur i politikës shqiptare”, pranoi të merrte pjesë në strukturat qeverisëse të asaj kohe. Autori e gjen përgjigjen, të nënkuptuar, në pyetjet që shtronte vetë Mehdi Frashëri.

Për trajtimin e çështjes së marrëdhënieve me Aleatët e Mëdhenj Antifashistë bëhen pohime pozitive e realiste për peshën e madhe politike, morale e ushtarake që pati për luftën tonë ndihma aleate. Mbahet dhe qëndrim kritik ndaj rolit të këtyre ndihmave, siç ishte ai i Enver Hoxhës i cili i minimizonte, duke i konsideruar “simbolike”.

Në tekst mbahen qëndrime kritike lidhur me marrëdhëniet e Lëvizjes Nacionalçlirimtare me atë jugosllave, për çështjen e Kosovës, duke pohuar drejtësinë e pikëpamjeve të Koço Tashkos, që lëvizjen në Kosovë ta drejtonte PKSH etj.

Ka gjetur pasqyrim objektiv trajtimi i çështjes çame dhe qëndrimi i çamëve në ngjarjet e Luftës II Botërore dhe gjenocidi që pësoi Çamëria gjatë kësaj lufte, si rezultat i qëndrimit antishqiptar të forcave politike greke.

Në tekst ka vlerësime objektive në trajtimin e reformave që kreu regjimi komunist, pas lufte, duke vënë në dukje veçoritë e shtetëzimeve të ndërmarrjeve vendase dhe të huaja, si masë paraprake për goditjen e pronës private.

Kanë gjetur pasqyrim ngjarjet që lidhen me rezistencën antikomuniste që në ditët e para të pasluftës.

Janë bërë përpjekje të mira për të trajtuar rrethanat politike të brendshme e të jashtme që përcaktuan përzgjedhjen e alternativës socialiste të zhvillimit të Shqipërisë pas lufte. Për herë të parë gjen pasqyrim në një tekst të tillë trajtimi i pikëpamjes kundër kësaj alternative dhe arsytimi që bëhej për zhvillimin e vendit në rrugën kapitaliste. Në tekst pohohet se “udhëheqja e PKSH zuri një pozicion ekstrem, jo vetëm në gjykimin e pikëpamjeve të S. Malëshovës, por dhe në trajtimin, në tërësi, të problemeve të zhvillimit të vendit”.

Ka gjetur pasqyrim dukuria e ndërtimit të institucioneve të shtetit komunist, nëpërmjet një pastrimi të njerëzve të padëshiruar dhe kundërshtarë të regjimit komunist dhe zëvendësimi me militantë e besnikë të Frontit e të qeverisë.

Është zbuluar qartë thelbi demagogjik i ligjit të 6 dhjetorit të vitit 1946 për krijimin e partive politike. “Ai mbeti në letër, pasi PK, me klimën që krijoi, nuk lejoi krijimin e partive të tjera. Fronti do të shërbente si fasadë për të mbuluar thelbin dhe natyrën e sistemit njëpartiak (të diktaturës)”.

Mendoj se kanë dalë në vija të përgjithshme problemet me të cilat u shoqëruan zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese të vitit 1945, sidomos përpjekjet e shumë elementëve për krijimin e opozitës brenda dhe jashtë Frontit.

Duket se janë bërë përpjekje për të shpjeguar si shkaqet e vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri, ecuri e shndërrimit të pushtetit, të vendosur që në luftë, drejt diktaturës. Në përfundim të vëllimit, ka gjetur shprehje ideja për shkaqet që çuan në rënien e këtij regjimi. Ato shkaqe gjenden në parimet e brendshme mbi të cilat ishte ngritur ky sistem, duke treguar se ky sistem nuk mund të shkonte më tej.

Me gjithë këto arritje e refleksione pozitive që u konstatuan në këtë vëllim, nuk do të thotë se ai i ka plotësuar të gjitha kërkesat e lexuesit për historinë objektive të vendit të tij. Duke qenë një vepër e disa autorëve, me formim e njohje të ndryshme nga njëri-tjetri, ata na kanë dhënë një vëllim me nivel jo të njëjtë shkencor të pjesëve përkatëse. Por në recensën tonë nuk do të merremi me këtë çështje, për të bërë dallimet, por do të vemë në dukje disa mangësi të përbashkëta, që u përkasin të gjithë autorëve.

1. Në gjithë vëllimin mungojnë referencat për burime dokumentare e bibliografike që kanë shfrytëzuar autorët. Përdorimi dhe pasqyrimi i burimeve me anë të referencave është një tregues themelor i nivelit, të mentalitetit si dhe i metodës që përdor autori, për të argumentuar çështjet dhe problemet që ai ka trajtuar.

Mungesa e referencave ka reflektuar dobësi të ndryshme në të gjithë vëllimin si subjektiviteti, njëanshmëria, tendencioziteti, shkarja në pozitat e një teksti me stil propagandistik dhe në mjaft raste prishjen e proporcioneve në trajtimin e rolit të forcave të ndryshme shoqërore, të peshës së tyre në procesin historik që lidhet me periudhën në fjalë.

Radhitja e burimeve, në fund të botimit, mbetet qëllim në vetvete, në rast se këto burime nuk referohen gjatë librit, sipas çështjes që trajtohet. Mungesa e tyre nuk krijon bindje për vërtetësinë e ngjarjeve dhe të rolit që kanë luajtur personazhet historike në to.

Mungesa e referencave vë në dyshim edhe pohime e afirmime pozitive, për të cilat folëm më parë, sepse ato mbetën si sythe apo fraza të shkëputura e pa vlerën bindëse për lexuesin, sepse nuk jepen si pjesë organike e trajtimit të të gjithë problemit.

Të dhënat e faktet që përmenden në vëllim janë të pabesueshme ose të dyshimta, kur lexuesit nuk i referohet burimi, për t'i dhënë të drejtën që ta verifikojë e të nxjerrë përfundimet e veta për shkallën e vërtetësisë të ngjarjeve që ka trajtuar në tekst autori. Mungesa e referencave nuk jep mundësinë të arrihet në përfundimin e saktë për shkallën e reflektimit të studimeve më të reja si dhe nivelin e afirmimit të tezave apo pikëpamjeve mbi problemet e historisë sonë kombëtare, të shtruara në sofrën e debatit dhe të kritikës shkencore.

Vërtet në vëllim janë veçuar sythe të veçantë që krijojnë probleme të kritikës shkencore, për pikëpamje të kundërta të autorëve rreth këtyre problemeve, por mungesa e referencave për autorët, të cilëve u bëhet kritika, të krijon përshtypjen se autori i vëllimit kërkon të imponojë vetëm pikëpamjet e tij. Aq e vërtetë është kjo dukuri sa që autori gati e mbyll debatin, kur dihet se në shkencë secili sjell argumentet e veta dhe situata për debat mbetet e hapur.

Për deformimet dhe rrjedhojat negative që sjell mungesa e referencave mund të sillen shumë raste që vihen re gjatë gjithë këtij vëllimi.

2. Në pjesën dërrmuese të vëllimit ngjarjet dhe proceset historike trajtohen të rrumbullakosura dhe në përgjithësi, pa u dhënë përgjigje pyetjeve ku? kur? dhe si? përgjigje, të cilat, i ka të domosdoshme çdo trajtim historik. Fjala vjen: thuhet se hitlerianët terrorizuan popullsinë civile në qytete e në fshatra. Me mijëra patriotë antifashistë “u arrestuan, u burgosën, u internuan në kampet e shfarosjes”. Duke u shprehur kështu, pa dhënë fakte konkrete, nuk bëhet histori, por vetëm propagandë.

Kur bëhet fjalë për dëmet e armikut apo tonat gjatë gjithë periudhës thuhet se ishin “të konsiderueshme”, “disa mijëra të vrarë”. Kjo rrjedh se teksti vuan nga mungesa e ngjarjeve dhe e fakteve të mbështetura në dokumente.

Kur trajtohet e analizohet programi dhe veprimtaria e organizatave ilegale pas luftës autori, mbështetet në materiale propagandistike të kohës, të cilat i demaskonin ata, për t’i paraqitur kriminelë përpara popullit. “U bënë thirrje që të mos e punonin tokën e dhënë nga reforma – thuhet në mënyrë të rrumbullakosur në tekst – dhe në qoftë se e punonin një pjesë të prodhimit t’ua jepnin ish pronarëve.

Por këto pohime mbeteshin thjesht fraza propagandistike kur nuk jepet asnjë e dhënë konkrete, që t’u përgjigjej pyetjeve: ku? kujt? kur?

3. Në shumë raste vihet re një trajtim tendencioz dhe i njëanshëm i problemeve. Një gjë e tillë duket kur trajtohet programi i PKS. Ky program duhet ballafaquar me detyrat që shtroreshin për t’u zgjidhur – çlirimi i vendit dhe jo të paraqitej “si dëshirë e disa të rinjve të pushtuar nga iluzionet romantike për zhdukjen e pabarazisë shoqërore si dhe të varfërisë në vend”. Ky motiv që trajtohej në programin e PKS, ishte një motiv nxitës i fuqishëm, për të marrë pushtetin në situatë lufte çlirimtare.

Kur autori trajton debatin historik mbi rolin e të dërguarve jugosllavë në formimin e PKS, ai i grupon studiuesit sipas dëshirës së tij. Në këtë rast ai e përfshin veten në atë grupim studiuesish, që i kanë kryer studimet, lidhur me këtë çështje, para viteve 90, që, siç dihet, janë mbështetur në metodën klasore e ideologjike.

Gjithashtu është tendencioz pikëpamja, sipas së cilës, “qarqet nacionaliste dhe ato zogiste nuk e kuptonin ngurrimin në luftë, duke u dhënë dorë komunistëve të merrnin ndikimin dhe të rrisnin prestigjin në opinionin publik”. Një pikëpamje e tillë, e shprehur në mënyrë tendencioze nuk përputhej me realitetin e ngjarjeve. Në fakt, ishin nacionalistët ata që organizuan veprimet e para të qëndresës së armatosur. Madje, ky begraund i nacionalistëve, veçanërisht i zogistëve, u shfrytëzua nga PKS, për t’u shtrirë në vend dhe për të propaganduar programin e saj.

Është tendencioz dhe i njëanshëm pohimi i bërë në vëllim, sipas të cilit “Nga fundi i vjeshtës 1943, krerët ballistë hynë në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me komandën e ushtrisë gjermane dhe pranuan që t’i mbështesnin ato në luftimet kundër forcave partizane”. Më parë ishte urdhri i Enver Hoxhës për shpalljen e luftës kundër Ballit Kombëtar, më 1 tetor 1943, Qarkorja e Mit’hat Frashërit, më 7 nëntor 1943 i përgjigjet në mënyrë të detyruar qëndrimit të PKS më 1 tetor 1943, që i shpallte luftë Ballit Kombëtar, për ta asgjësuar ushtarakisht.

Mënjanimi dhe injorimi tendencioz i procesit të fillimit e të zhvillimit të luftës civile, që ishte një realitet i pamohueshëm, përbën një ngërç

metodologjik në shpjegimin dhe shqyrtimin e ngjarjeve të mëvonshme të luftës në Shqipëri, sidomos të marrëdhënieve e raporteve konfliktuale midis forcave politike shqiptare.

Pikërisht për këtë, në mënyrë tendencioze, nuk thuhet arsyeja e vërtetë pse ndodhi ndarja e A.Kupit nga Fronti Nacionalçlirimtar dhe krijimi i Lëvizjes së Legalitetit, etj.

Është tendencioz dhe i njëanshëm trajtimi në vëllim i qëndrimit dhe i veprimtarisë së Muharrem Bajraktarit. Nuk jepet veprimtaria e tij kundër italianëve dhe gjermanëve, por jepet takimi me Mihajllloviçin (“sipas burimeve të huaja”, pa referenca). Në këtë kuadër, shtrembërohet qëndrimi i tij në bisedimet me forcat e LNÇ, dhe masakra që bënë këta të fundit me pabesinë e tyre, si shprehje e qartë e zhvillimit të luftës civile në Veri. Në mjaft raste vihen re paragjykitime e supozime tendencioze për zhvillimin e ngjarjeve pas përfundimit të luftës, sipas të cilave, “forcat balliste dhe nacionaliste (A.Kupi, M.Bajraktari, Kryezinjët) kërkonin të ruanin forcat, të shmangen reprezaljet dhe shkatërrimet e mundshme, për t’i përdorur forcat në ballafaqimin e pashmangshëm me komunistët, për të mos lejuar ardhjen e tyre në pushtet”. Supozime dhe hamendje të tilla jo vetëm nuk mbështeten në fakte, por janë dhe shtrembërime të realitetit historik. Hezitimin e këtyre nacionalistëve, për të mos u përleshur me bashkatdhetarët e vet, autori e sheh në dritë të shtrembër, nga pozita të theksuara subjektive, klasore dhe jo kombëtare.

Duket qartë se, përgjegjësia e luftës civile (ndonëse nuk pranohet në mënyrë të drejtpërdrejtë), me tendencë, i ngarkohet “rreshtimit e qëndrimit të gabuar të forcave kryesore nacionaliste: Ballit Kombëtar dhe Legalitetit”. Kështu, mënjanohet dhe injorohet qëndrimi i gabuar i PKS, e cila luftën për pushtet e vuri në plan të parë, për të asgjësuar kundërshtarët politikë të saj dhe luftën kundër pushtuesit e shfrytëzoi si garniturë, për të justifikuar veprimet e saj të luftës civile, duke iu imponuar kundërshtarëve politik bashkëpunimin edhe me pushtuesin, për të mbijetuar. Ky bashkëpunim i tyre ishte tepër i vonshëm, kur me fatin e gjermanëve u bashkua dhe fati i nacionalistëve shqiptarë. Si të tillë, këta të fundit, ishin një forcë inekzistente, për të penguar vendosjen e pushtetit komunist.

Nuk mund të konsiderohet si një “harresë” mënjanimi i qëndrimit të Britanisë së Madhe ndaj Ahmet Zogut, e cila nuk duhet trajtuar si një çështje private ndaj personit të tij, por si një çështje e qëndrimit ndaj shtetit shqiptar të paraluftës.

Mungesa e trajtimit të kësaj çështjeje, e cila ka gjetur pasqyrim në mjaft studime, të botuara vitet e fundit, është një injorim i pajustificuar i qëndresës e përpjekjeve të mbretit shqiptar, në drejtim të mbrojtjes së çështjes shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore si një drejtim i rëndësishëm i rezistencës nga emigracioni.

Gjatë trajtimit të qëndrimeve të kundërta për çështjen e Kosovës, duket qartë qëndrimi i njëanshëm i autorit ndaj kësaj çështjeje. Ai i mbetet besnik pikëpamjes politike, sipas së cilës, çështja e Kosovës do të zgjidhej sipas orientimeve të Kominternit dhe udhëzimeve e porosive të Koalicionit Antifashist, mbështetur në të drejtën e vetëvendosjes.

Duke iu përmbajtur kësaj pikëpamjeje autori gjen pika përputhje midis lëvizjeve nacionalçlirimtare në Shqipëri e Jugosllavi, gjatë e pas luftës, bashkëpunim që e minoi hapur zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Duke mbështetur këtë pikëpamje në tekst, janë mënjeluar ngjarje e veprime politike e luftarake në Kosovë, që çuan në ripushtimin jugosllav të saj. Edhe në trojet e tjera etnike shqiptare janë evituar nga autori operacionet dhe reprezaljet e ushtrisë jugosllave kundër shqiptarëve, të cilët nuk e pranonin këtë ripushtim.

Megjithatë, për këtë çështje në tekst ka dhe vlerësim tjetër që bie ndesh me gjithë trajtesën “Vlerësimi i bashkimit të Kosovës me Shqipërinë nga ana e PKS. Ky bashkim paraqitet nga autori si një veprim demagogjik, ishte tepër tendencioz e i njëanshëm dhe mbi të gjitha absurd, për të gjithë shqiptarët e trojeve shqiptare në ish Jugosllavi, i pakuptueshëm”. Në këtë optikë, sipas autorit, duhej trajtuar qëndrimi për çështjen e Kosovës.

- Gjatë trajtimit të historisë së Kosovës, gjatë Luftës së Dytë Botërore, ndeshen mjaft trajtime konformiste, të mbështetura mbi një skemë të paracaktuar. Këto mangësi i gjejmë: në këndvështrimet e procesit të bashkimit të Kosovës me Shqipërinë dhe rrjedhojat që pati bashkimi për shqiptarët; në potencimin e ngjarjeve në Kosovë në vitet 1941-1943 si shprehje e qëndresës antifashiste të Kosovës; për bashkëpunimin midis lëvizjeve nacionalçlirimtare, për ndihmën e forcave të UNÇSH në Kosovë e Jugosllavi, për zbehjen e qëndresës së shqiptarëve ndaj ripushtimit jugosllav, etj.

Nuk është argumentuar qëndrimi bashkëpunues i udhëheqjes së LNÇSH me atë jugosllave edhe pse kishte mjaft indikacione për qëndrimin antishqiptar të udhëheqjes jugosllave.

Nuk mund të kuptohet se si mbahen rezerva akoma, për të mos i thënë ngjarjet historike me emrin e vet, për të njohur të vërtetën historike.

4. Kam mendimin se trajtimi i çështjes “Zhvillimet politike në Partinë Komuniste” është bërë si qëllim në vetvete”, që nuk ngre peshë në tematikën e historisë kombëtare. Trajtohen plenumet e kongreseve njëjloj sikur shkruhet historia e Partisë Komuniste. Do të ishte mirë që kjo çështje të shkruhej me problematikën tjetër, ku të përfshiheshin goditjet e grupeve antiparti.

5. Vëllimi ka nevojë për të evituar pasaktësi që kanë të bëjnë me kohën e zhvillimit të ngjarjeve si dhe të disa ilustrimeve me foto të cilat janë të paidentifikuara e të përgjithshme, që nuk japin asgjë për ilustrim.

Për një vëllim të tillë me përmasa relativisht të mëdha, duhej të pretendohesh edhe për më shumë përgjegjësi profesionale shkencore. Në këtë

kuptim mund të shkruhej në këtë recensë edhe më tepër për mjaft çështje e probleme që kanë të bëjnë me metodën me botëkuptimin e autorëve. Megjithatë, do të bashkohesha me thënien e shprehur në parathënien e këtij vëllimi se në një shoqëri demokratike nuk mund të ketë një shpjegim përfundimtar për çështjet e shkencës në tërësi e aq më shumë të shkencës historike. Në këtë kuptim, ky vëllim mbetet i hapur ndaj debatit shkencor, në kuptimin që mund të thuhet edhe më tepër dhe më ndryshe nga kjo recensë. Prandaj vëllimi mund të shohë dritën e botimit për lexuesin, që ky i fundit të shprehë mendimin e tij për të.

Muharrem DEZHGIU